

Projekti “Green Waters Adventure - Touristic Growth of Water Landscapes and Cities”

Programi Interreg IPA CBC Itali – Shqipëri, Mali i Zi 2014-2020

Projekti Green Waters Adventure (G.W.A) konsiston në promovimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të turizmit sportiv dhe aventuror, në përputhje me objektivin specifik të programit për shfrytëzimin e turizmit ndërkufitar dhe atraktivitetit territorial për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Projekti G.W.A synon të rrisë bashkëpunimin midis Italisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi, duke krijuar një strategji të përbashkët për menaxhimin e turizmit duke sjellë në të njëjtin standard nivelin e produkteve dhe shërbimeve të ofruara, nën një identitet unik të markës ndërkufitare në gjendje të identifikojë veçoritë e zonës. Rezultati kryesor i projektit është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm, të përhapur dhe inovativ ndërkombëtar të turizmit sportiv dhe aventuror, që do të nxjerrë në pah trashëgiminë kulturore dhe natyrore duke stimuluar ekonominë lokale dhe duke krijuar mundësi të reja pune dhe sipërmarrje ekonomike.

Projekti G.W.A bashëfinancohet nga Programi Interreg IPA Itali – Shqipëri - Mali i Zi 2014 - 2020 me synim rritjen e atraktivitetit të pasurive natyrore dhe kulturore në zonën e bashkëpunimit, për të patur një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Vlera totale e projektit është 402.096,99 euro.

Lider në këtë projekt është Ente Parco Nazionale del Gargano (IT) dhe zbatohet në partneritet me Politecnico di Bari (IT), Turisticka Organizacija Ulcinj (ME) Ministria e Kulturës (AL), Comune di Castel San Vincenzo (IT). Territoret e tyre përkatëse do të përfshihen në ndërtimin e një sistemi të aftësive menaxheriale dhe eksperimentimin e zgjidhjeve dhe mjeteve inteligjente si pjesë e një strategjie të përbashkët oferte të zgjuar turistike.

Për më shumë informacion: <https://gwa.italy-albania-montenegro.eu/>

Kontakt i Liderit të Projektit:

Vincenzo Totaro, Director of Ente Parco Nazionale del Gargano

e-mail: direttore@parcogargano.it